ALBANIAN UNIVERSITY

RREGULLORE

"PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË SENATIT AKADEMIK NË ALBANIAN UNIVERSITY"

Miratohet

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Julian Fink

Tiranë, më 20.05.2026

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME 2
Neni 1 - Objekti 3
Neni 2 - Baza ligjore 3
Neni 3 - Përkufizime 3
Neni 4 - Roli i Senatit 4
KREU II - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SENATIT 4
Neni 5 - Kompetencat e Senatit 4
Neni 6 - Përbërja e Senatit 5
KREU III - VEPRIMTARIA E SENATIT 6
Neni 7 - Mbledhjet e Senatit 6
Neni 8 - Thirrja e mbledhjeve 7
Neni 9 - Rendi i ditës 7
Neni 10 - Zhvillimi i mbledhjeve në përjashtim nga rregulli 7
Neni 11 - Kuorumi 8
Neni 12 - Drejtimi i mbledhjes 8
Neni 13 - Amendamentet 8
KREU IV - VENDIMMARRJA E SENATIT 8
Neni 14 - Vendimet 8
Neni 15 - E drejta e vetos 9
Neni 16 - Procesverbali 9
KREU V - DISPOZITA TË FUNDIT 9
Neni 17 - Të fundit 9

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore Pune përcakton në mënyrë të hollësishme veprimtarinë e organit drejtues të Senatit Akademik në Albanian University (AU).

Neni 2
Baza ligjore

1. Senati Akademik është organi kolegjial më i lartë akademik në nivelin qendror të Albanian University (AU), i krijuar në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme në fuqi.
2. Veprimtaria e Senatit të AU-së mbështetet në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në ligjin nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, në Statutin e AU-së, Rregulloren e Përgjithshme të AU-së dhe në këtë Rregullore Pune.
3. Kjo Rregullore Pune del në zbatim të delegimit të Statutit të AU-së.
4. Parashikimet e kësaj Rregulloreje Pune interpretohen, zbatohen, dhe kur është rasti, plotësohen dhe/ose zëvendësohen, në harmoni me dispozitat dhe frymën e akteve normative të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, sipas parimeve të përgjithshme të hierarkisë së normave.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje Pune, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:
   a) **"Rregullore Pune"**, Rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Senatit Akademik në Albanian University";
   b) **"Senati"**, Senati Akademik i AU-së;
   c) **"Anëtar"**, anëtar i Senatit Akademik të AU-së, me të drejtë vote, i zgjedhur në përputhje me parashikimet statutore;
   d) **"Pjesëmarrës"**, palë të interesuara në mbledhjet e Senatit, pa të drejtë vote, të ftuara sipas procedurave të kësaj Rregulloreje Pune, përfshirë Sekretarin dhe pjesëmarrësit për shkak të funksionit;
   e) **"Kryetar"**, Rektori si autoriteti më i lartë drejtues akademik dhe Kryetari *ex officio* i Senatit Akademik;
   f) **"Mbledhje"**, mbledhja e Senatit Akademik, e zakonshme dhe e jashtëzakonshme;
   g) **"Amendament"**, propozim me shkrim për ndryshime në përmbajtjen e projektaktit që shqyrtohet nga Senati;
   h) **"Votim i fshehtë"**, procedurë votimi në të cilën deklarimi i votimit individual në Senat nuk bëhet publik dhe regjistrohet vetëm rezultati përfundimtar i votimit, për shkak të ndjeshmërisë së çështjes që i nënshtrohet votimit;
   i) **"Veto"**, e drejta statutore e Rektorit si Kryetar i Senatit për ta pezulluar dhe kthyer për rishqyrtim vetëm një herë vendimin e Senatit.
2. Termat e tjerë të përdorur në këtë Rregullore Pune, të papërkufizuara në pikën 1 të këtij neni, kanë të njëjtin kuptim si ato në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU-së.

Neni 4
Roli i Senatit

1. Senati Akademik është organi drejtues përgjegjës për përmbushjen e misionit dhe vizionit të AU-së.
2. Veprimtaria e Senatit përqëndrohet në planifikimin, programimin, bashkërendimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e proceseve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Senati përcakton politikat kryesore të zhvillimit të AU-së dhe garanton sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në AU nëpërmjet mekanizmave të krijuara për këtë qëllim.
3. Senati merr në shqyrtim çdo propozim të paraqitur, brenda kompetencave të tij, përfshirë nga nivelet më të ulëta të strukturave akademike dhe njësive, lidhur kryesisht me programet e studimit dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore.
4. Senati Akademik garanton dhe udhëhiqet në veprimtarinë e tij nga parimet e autonomisë së AU-së, lirisë akademike dhe të drejtave të studentëve.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SENATIT

Neni 5
Kompetencat e Senatit

1. Senati Akademik, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU-së, është përgjegjës për vendimarrjen lidhur me çështjet kryesore të mëposhtme:
   a) përcaktimin e politikave të zhvillimit të AU-së dhe miratimin e strategjive të zhvillimit të universitetit;
   b) miratimin e vendosjes së marrëdhënieve dhe lidhjes së marrëveshjeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me institucione të tjera, në bazë të propozimit të fakulteteve, për qëllimet e zhvillimit institucional dhe veprimtarisë mësimore të AU-së;
   c) miratimin e hapjes së programeve të reja të studimit, projekteve shkencore, ndryshimeve dhe riorganizimeve në programet ekzistuese, si dhe mbylljes së tyre, pasi është marrë vlerësimi paraprak nga Bordi i Administrimit;
   d) mbi bazën e propozimeve të departamenteve, miraton kuotat dhe kriteret e pranimit në secilin program studimi;
   e) propozon për miratim në Bordin e Administrimit, planin strategjik të zhvillimit të AU-së, të hartuar nga Rektorati;
   f) propozon për miratim në Bordin e Administrimit, projektbuxhetin vjetor dhe planin afat-mesëm 3-vjeçar të AU-së, të hartuar nga Administratori i Përgjithshëm;
   g) miraton në parim raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit, të paraqitur nga Administratori i Përgjithshëm në fund të vitit akademik, dhe ia përcjell Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar;
   h) miraton programin vjetor të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe raportin e detajuar vjetor të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të AU-së, të hartuara nga Rektorati. Në rastin e raportit vjetor, pas miratimit paraprak të Bordit të Administrimit ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
   i) harton strukturën e përgjithshme të AU-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit akademik dhe administrativ në të gjithë nivelet, si dhe miraton në parim kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të

formuluara nga Rektorati, dhe ia paraqet ato për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit;

j) miraton kriteret e punësimit për personelin akademik, të propozuara nga njësitë në nivel institucional, dhe ato për personelin ndihmësakademik, të propozuara nga njësitë ku ky personel shërben;
k) miraton projektstatutin e AU-së me shumicë prej 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë anëtarëve, pas miratimit paraprak të Bordit të Administrimit, dhe miraton me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm Rregulloren e Përgjithshme dhe rregulloret e tjera të AU-së, si dhe ndryshimet në to;
l) krijon dhe miraton përbërjen e Komisioneve të Përhershme dhe të Këshillit të Etikës të AU-së;
m) zgjedh Rektorin e AU-së, mbi bazën e të paktën 2 (dy) kandidaturave alternative;
n) me propozim të Rektorit, zgjedh Dekanin e fakultetit, mbi bazën e një procesi konkurrimi, si dhe emëron dhe shkarkon Zëvendësrektorët;
o) propozon në Bordin e Administrimit tarifat e studimit dhe ndryshimin e tyre, si dhe ndryshimet në nivelin e pagave të personelit akademik dhe ndryshimin e tarifës së orës mësimore;
p) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit.

2. Senati ushtron edhe kompetenca të tjera, si më poshtë:
   a) kërkon mendim nga organet e tjera drejtuese dhe shprehet kur i kërkohet mendim nga të njëjtët;
   b) gëzon të drejtën e interpretimit të akteve normative të brendshme;
   c) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të AU-së ose degëve të tij, mbi bazën e propozimeve të fakulteteve dhe departamenteve, pasi ka marrë vlerësimin paraprak nga Bordi i Administrimit, si dhe propozon në Bord mbylljen, riorganizimin, ndarjen ose bashkimin e AU-së me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
   d) propozon politikat e veçanta për trajtimin financiar të kategorive të veçanta sociale dhe të studentëve pjesë të Programit të Ekselencës, dhe ia përcjell ato për miratim Bordit të Administrimit, si dhe miraton kriteret dhe listën emërore të diplomantëve që përfitojnë Medalje të Artë dhe Certifikatë Ekselence, mbi bazën e rezultateve të arritura në përfundim të studimeve të tyre;
   e) zgjedh kryeredaktorin, zëvendëskryeredaktorin dhe miraton përbërjen e redaksisë dhe të Bordit Drejtues të Revistës Optime;
   f) merr vendime mbi ndryshimin ose shfuqizimin e akteve të fakulteteve, të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe rregulloret përkatëse, si dhe shqyrton dhe shfuqizon, kryesisht ose me kërkesë të të interesuarit, vendimet e Komisioneve të Përhershme, kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi, Statutin ose rregulloret përkatëse;
   g) me kërkesë të fakulteteve ose departamenteve, Senati mund të miratojë, jashtë kalendarit akademik, organizimin e sesioneve të ndërmjetme të provimeve, të jashtëzakonshme ose të kufizuara, të riprovimeve ose të provimeve të mbartura;
   h) ka të drejtë që, kur e çmon të arsyeshme, të caktojë kritere të veçanta për pranimin e studentëve në programet e studimit, për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik, si dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Etikës dhe të Komisioneve të Përhershme, me shumicë të thjeshtë të votave në prani të të gjithë anëtarëve të tij;
   i) miraton planin strategjik të zhvillimit të fakultetit, të paraqitur nga Asambleja e Personelit Akademik;

j) miraton raportin vjetor të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të përcjellë nga Komisioni për Vlerësimin Institucional;
k) pas pëlqimit të ministrisë përgjegjëse, akordon titullin "*Doctor Honoris Causa*" për personalitete të ndryshme nga vendi dhe bota, me propozim të Rektoratit, si dhe titullin "*Professor Emeritus*" pas daljes në pension, personelit akademik "Profesor" me veprimtari të spikatur, me propozim të departamentit ku ka zhvilluar karrierën dhe sipas kritereve të brendshme;
l) shqyrton edhe çdo çështje tjetër në përputhje me nenin 4, pika 3 të kësaj Rregulloreje Pune.

Neni 6
Përbërja e Senatit

1. Senati Akademik është organ me vendimmarrje kolegjiale, i cili kryesohet nga Rektori i AU-së dhe përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë me të drejta të plota, përfaqësues të zgjedhur të grupimeve të mëposhtme:
   a) përfaqësues të personelit akademik: 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë;
   b) përfaqësues të studentëve: 1 (një) anëtar, i cili është Kryetari i Këshillit Studentor të AU-së.
2. Raportet e përfaqësimit të fakulteteve në Senat dhe rregullat mbi mandatin e anëtarit zbatohen në përputhje me parashikimet e Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të AU-së.

KREU III
VEPRIMTARIA E SENATIT

Neni 7
Mbledhjet e Senatit

1. Senati Akademik mblidhet periodikisht, së paku 3 (tre) herë gjatë një semestri. Senati mblidhet në rastet e parashikuara nga aktet normative në fuqi dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e AU-së.
2. Mbledhjet e Senatit janë të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Ato thirren në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 8 të kësaj Rregulloreje Pune.
3. Mbledhjet e zakonshme të Senatit mbahen, si rregull, ditën e mërkurë. Shmangia nga ky rregull mund të bëhet vetëm për shkaqe të arsyeshme, duke mbajtur parasysh afatet procedurale.
4. Në fund të çdo viti akademik, Senati organizon një mbledhje të përbashkët me Bordin e Administrimit, ku diskutohet mbi veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare.

Neni 8
Thirrja e mbledhjeve

1. Mbledhjet e radhës të Senatit Akademik thirren nga Rektori, 10 (dhjetë) ditë pune përpara datës së parashikuar. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet u njoftohet të gjithë anëtarëve dhe pjesëmarrësve, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjeve bëhet elektronikisht dhe përmban ftesën për të paraqitur propozime për rendin e ditës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 9.
3. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me kërkesën e Kryetarit ose e 1/3 (një të tretës) së anëtarëve. Pala kërkuese ka detyrimin të arsyetojë thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme.
4. Me ftesën e Kryetarit ose 1/4 (një të katërtës) së anëtarëve, në mbledhje mund të jenë të pranishëm edhe pjesëmarrës që kanë lidhje me çështjet që merren në shqyrtim.
5. Anëtari ka detyrimin të njoftojë me shkrim pamundësinë për të marrë pjesë në mbledhje, dhe sipas rastit e shoqëron njoftimin me dokumente provuese. Në rast pamundësie për të njoftuar paraprakisht, anëtari ka detyrimin të parashtrojë me shkrim sa më parë shkaqet e mungesës dhe pamundësisë së njoftimit. Mosrespektimi i këtij detyrimi mund të përbëjë shkak për mbarimin e mandatit të anëtarit, në përputhje me Statutin e AU-së.

Neni 9
Rendi i ditës

1. Çdo anëtar dhe strukturë mbështetëse ka të drejtë të propozojë çështje për rendin e ditës të mbledhjeve pasardhëse të Senatit, me shkrim ose në mënyrë elektronike nëpërmjet formularëve të veçantë të shpërndarë për këtë qëllim, së bashku me dokumentacionin shoqërues, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi i Rektorit sipas nenit 8.
2. Rektori, në bashkërendim me Zëvendësrektorët dhe Dekanët e fakulteteve, formulon dhe përcakton rendin e ditës dhe çështjet kryesore që do të diskutohen. Rendi i ditës përfshinë çështjet e propozuara sipas pikës 1 të këtij neni të cilat janë në kompetencën e Senatit.
3. Bashkërendimi në kuptim të pikës 2 të këtij neni ka natyrë administrative dhe nuk përbën shkak për përjashtimin e çështjeve të propozuara sipas procedurës.
4. Propozimet që janë të paplota ose nuk shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm mund të refuzohen ose të merren parasysh për mbledhjet pasardhëse. Pas caktimit të rendit të ditës në kuptim të pikave 2 dhe 3 të këtij neni, nuk mund të vendosen pika të tjera në rendin e ditës, me përjashtim të rasteve urgjente të arsyetuara dhe me miratimin e shprehur të Kryetarit. Propozimet e paraqitura pas afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përfshihen në rendin e ditës vetëm me të njëjtin miratim.
5. Anëtarët dhe pjesëmarrësit e tjerë kanë të drejtë të njihen me rendin e ditës dhe dokumentacionin shoqërues, të paktën 4 (katër) ditë pune përpara zhvillimit të mbledhjes, nëpërmjet njoftimit rishtas. Me përjashtim të rastit të nenit 10, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë shtyrjen e mbledhjes kur nuk është respektuar ky afat, ose pasqyrimin e këtij fakti në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 10
Zhvillimi i mbledhjeve në përjashtim nga rregulli

Mbledhja e Senatit është e vlefshme edhe kur nuk janë respektuar procedurat e parashikuara për thirrjen dhe njoftimin e rendit të ditës, vetëm në raste urgjente dhe kur në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët, aty për aty miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

Neni 11
Kuorumi

1. Mbledhja e Senatit është e vlefshme kur në të janë të pranishëm më shumë se 1/2 (një e dyta) e anëtarëve.
2. Kur në mbledhje nuk arrihet kuorumi i përcaktuar në pikën 1, Kryetari vendos shtyrjen e mbledhjes në ditën e punës më të afërt.

Neni 12
Drejtimi i mbledhjes

1. Mbledhjet e Senatit drejtohen nga Rektori i AU-së, njëherazi Kryetari i tij. Rektori ka të drejtë t'ia delegojë kompetencën e drejtimit të mbledhjes së Senatit njërit prej Zëvendësrektorëve, vetëm në kushtet kur prania e Rektorit pamundësohet për shkaqe pune ose shëndetësore, si dhe kur mbledhja e Senatit ka karakter urgjent.
2. Mbledhja hapet nga Kryetari duke filluar me verifikimin e kuorumit të nevojshëm dhe pranisë së pjesëmarrësve, si dhe legjitimimin e tyre sipas rastit. Mbledhja më pas kalon në leximin dhe miratimin e rendit të ditës dhe çështjeve që do të diskutohen dhe votohen. Mbledhja vijon me prezantimin e çështjeve nga Kryetari, anëtarët dhe/ose përfaqësuesit e strukturave propozuese, me zhvillimin e diskutimeve, dhënien e mendimeve nga të pranishmit, diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës, dhe me hedhjen në votim të propozimeve.

Neni 13
Amendamentet

1. Çdo anëtar ose Kryetari kanë të drejtë të paraqesin në mbledhjen e Senatit amendamente me shkrim për projektpropozimin e paraqitur, me kusht që ato të jenë dorëzuar paraprakisht në sekretarinë e Senatit të paktën 24 (njëzet e katër) orë përpara fillimit të mbledhjes dhe t'u jenë shpërndarë të gjithë anëtarëve dhe pjesëmarrësve.
2. Amendamentet hidhen në votim përpara tekstit të projektaktit.

KREU IV
VENDIMMARRJA E SENATIT

Neni 14
Vendimet

1. Senati, në ushtrimin e funksioneve të tij, shprehet me vendime.
2. Vendimet e Senatit merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur çështja kërkon shumicë të cilësuar votash.
3. Votimi në Senat është i hapur. Në raste të veçanta, sipas natyrës së vendimmarrjes, Senati, me vendimin e tij paraprak, mund të vendosë që votimi të bëhet i fshehtë. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet edhe nga Kryetari ose nga të paktën 1/3 (një e treta) e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Votimi i fshehtë realizohet nëpërmjet votimit me fletë votimi ose nëpërmjet mjeteve ose sistemeve elektronike të cilat garantojnë fshehtësinë e votimit.
4. Anëtari mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë.
5. Anëtari, i cili ndodhet përpara konfliktit të interesave ose ndonjë pengese tjetër ligjore, nuk duhet të jetë i pranishëm gjatë diskutimeve dhe procesit të votimit. Deklarimi i konfliktit të

interesave ose pengesës bëhet sa më parë dhe vendimi për dorëheqjen e tij merret nga Kryetari.

6. Në procesin e votimit, Kryetari voton i fundit, dhe në rast barazie midis votave "pro" dhe "kundër", vota e Kryetarit është vendimtare për përcaktimin e rezulatit.
7. Kryetari, në bashkëpunim me administratën, brenda 3 (tre) ditëve pune nga zhvillimi i mbledhjes, formalizon në dokument zyrtar vendimin e Senatit, e nënshkruan atë, dhe sipas rastit e shoqëron dërgimin e tij në strukturat vartëse akademike dhe administrative me urdhra konkrete për zbatim.

Neni 15
E drejta e vetos

1. Në përputhje me parashikimet statutore dhe rregullatore, Rektori ka të drejtën e vetos pezulluese mbi vendimin e Senatit, duke e kthyer atë për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Kur mbas rishqyrtimit, Senati e miraton vendimin të pandryshuar, vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Neni 16
Procesverbali

1. Mbledhjet e Senatit pasqyrohen detyrimisht në procesverbalet përkatëse nga Sekretari i Senatit, të cilat mbahen me shkrim dhe mund të regjistrohen njëkohësisht edhe me zë. Në rastet kur bëhet regjistrimi, transkriptimi i plotë i mbledhjes bëhet vetëm në rastet kur një gjë e tillë është e nevojshme. Pavarësisht mënyrës së mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes, në procesverbalin me shkrim pasqyrohet, me pasojë pavlefshmërie, dispozitivi i plotë i vendimeve të marra.
2. Deklarimi dhe dorëheqja sipas nenit 14, pika 5 e kësaj Rregulloreje Pune pasqyrohen detyrimisht në procesverbalin e mbledhjes.
3. Procesverbali miratohet në fillim të mbledhjeve pasardhëse. Pas miratimit, ai nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari, si dhe arkivohet.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Të fundit

1. Rregullorja "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Senatit Akademik", miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 2, datë 22.12.2016, dhe ndryshuar me vendimin nr. 54, datë 10.10.2018, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje Pune.
2. Kjo Rregullore Pune hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe nënshkrimit nga Kryetari i tij.
3. Rregullorja e Punës i nënshtrohet shtesave dhe ndryshimeve sipas së njëjtës procedurë që ndiqet për miratimin e saj.

Miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 24, datë 20.05.2026

ALBANIAN UNIVERSITY AU